Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar”.

Projektligji synon rritjen e nivelit të mbrojtjes së specieve të faunës së egër dhe ruajtjen e habitateve të tyre natyrore, duke siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në menaxhimin e tyre.

Projektligji parashikon gjithashtu përmirësimin e sistemit të licencimit dhe forcimin e kontrollit mbi kopshtet zoologjike dhe subjektet që mbajnë faunë të egër në robëri, me qëllim garantimin e respektimit të standardeve të mirëqenies së kafshëve dhe kushteve të sigurisë. Në të njëjtën kohë, synohet rritja e efektivitetit të masave administrative dhe sanksioneve për shkeljet e dispozitave ligjore, duke forcuar mekanizmat e parandalimit dhe ndëshkimit të shkeljeve në këtë fushë.

Gjithashtu, projektligji synon përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e faunës së egër, me qëllim rritjen e efikasitetit të monitorimit, inspektimit dhe zbatimit të masave ligjore në praktikë.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 12.6.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: 1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Ministrinë e Mjedisit.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit publik ishte 10.7.2026.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar”, relacioni përkatës si dhe njoftimi për pjesëmarrje në takimet konsultative, u publikuan në linkun, www.konsultimipublik.gov.al.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, nga data 12.6.2026 deri në datën 10.7.2026. Përgjatë kësaj periudhe ka patur 465 shikime në RENJKP, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP dhe as nëpërmjet postës elektronike.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.
Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Ky projektligj është hartuar nga strukturat e Ministrisë së Mjedisit, mbi bazën e mbështetjes që ka dhënë projekti EU for Nature të administruar nga UNDP.

Gjatë procesit të konsultimit, nuk janë paraqitur komente dhe sugjerime nga palë të interesuara.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nuk ka komente.

Çështja e adresuar	**Komenti**	**Palët e interesuara**	**Vendimi**	**Justifikimi**